



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200851/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e bërë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Elbasan.

**Drejtuar:** Drejtues i parë Ardian ÇIPA  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan

ELBASAN

Kryekomisar Alfred CENAJ  
Shef i Komisarariatit të Policisë Elbasan

ELBASAN

**Për dijëni:** Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

*Të nderuar zotërinj,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Elbasan.

Inspektimi u krye në datën 15.06.2022, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektiveve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me zv/Drejtorin e Policisë Elbasan z. Artur Selimi dhe zv/shëfën e Komisarariatit z. Leonard Allkja, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, zv/shëfi i komisarariatit informoi për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë pranë këtij komisaritati, zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore nga punonjësit e policisë të komisarariatit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me përgjegjësën e dhomave të sigurisë, punonjësin e dhomave të shoqërimit, dhe shëfën e logjistikës pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, gjatë evidentimit të kushteve në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Elbasan.

Grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisaritati.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në mjediset e komisarariatit. U evidentua se, punonjësit e policisë ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe ruanin distancën fizike me njëri tjetrin. Në vende të aksesueshme (korridore) ishin vendosur dezinfektant për pastrimin e duarve. Gjithashtu, dezinfektantë për pastrimin e duarve ishin vendosur edhe në korridorin ku ndodhej ambienti i shoqërimit, si dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Maskat mbrojtëse dhe dezinfektantët ishin siguruar nga Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Elbasan. Vlen të theksohet se situata e pandemisë është e tillë që ka lejuar lehtësimin thelbësor të masave.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e shërbimit të Komisarariatit të Policisë Elbasan me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm<sup>1</sup>, rezultoi se:

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I25-2 prot., datë 02.08.2021.

- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për kompletimin e dy dhomave të sigurisë me shtrat për fjetjen e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve të vjetruara të fjetjes me materiale të reja deri në rikonstrukcionin e plotë të këtyre dhomave.
- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e menjëhershme të masave për plotësimin e organikës me psikolog pasi mungesa e tij ndikon ndjeshëm në mbarëvajtjen e punës në këtë institucion.
- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e xhamave në dritaren e dhomës të shoqërimit për gra, lyerjen e dezinfektimin, si dhe kompletimin e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.
- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e një regjistri të veçantë për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku të evidentohen të gjitha rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave të nevojshme për mbylljen e dhomave ekzistuese të sigurisë dhe ndërtimin e ambienteve të reja të ndalim/arrestimit në Komisarlatin e Policisë Elbasan, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës, lyerjen dhe dezinfektimin e dhomave të sigurisë.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Elbasan, sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar dhoma shoqërimi të ndara më vete për personat meshkuj të rritur, femra dhe të mitur.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave në Komisarlatin e Policisë Elbasan, ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.

- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare si dhe plotësimin e nevojave me detergjentë dhe furnizimin me ujë të pijshëm pa ndërprerje.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave për të vendosur posterat e rinj me të drejtat e personave që shoqërohen apo ndalohen në ambientet e komisariateve, në vende që të jenë të aksesueshëm nga këta persona.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Përsa një pjesë e rekomandimeve mund të kërkojnë buxhete e janë pjesë e planeve më afatgjata, Avokati i Popullit konstaton me shqetësim se një pjesë e rekomandimeve të bëra e të pazbatuara janë tërësisht rezultat i neglizhencës në zbatimin e ligjit.

Me shkresën nr. 2545 prot., datë 8.04.2022 është dërguar informacion pranë Drejtorit të Policisë Vendore mbi kontrollin e ushtruar në dhomat e sigurisë /shoqërimit të Komisarivateve të Policisë në zbatim të Plan-Kontrollit duke e informuar mbi gjetjet dhe nevojat për ndërhyrje.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se në ambientet aktuale në Komisarivat e Policisë Elbasan, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarivat e Policisë Elbasan, ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të mbajtjes dhe qëndrimit të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit<sup>2</sup>.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisarariatit, me dalje në pjesën e pasme në oborrin e institucionit. Ai përbëhej nga 2(dy) dhoma shoqërimi, një dhomë shoqërimi për personat në moshë madhore dhe një dhomë shoqërimi për gra. Personat e shoqëruar të mitur, në mungesë të një dhome më vete qëndronin në zyrën e specialistëve të policisë (SPZ), e cila ndodhej ngjitur me dy dhomat e shoqërimit.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të mjaftueshme, për mbajtjen dhe qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Kapacitet e dhomave të shoqërimit ishin për mbajtjen dhe qëndrimin e deri 5(pesë) personave në secilën dhomë. Ato

<sup>2</sup> Kreu VII, pika 4 gërmat b,c,d *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

kishin dritare me skarë dhe rrjetë hekuri që lejonte ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, por dhomat kishin edhe ndriçim me llampë që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Gjatë inspektimit u konstatua se, dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të lyera dhe **nuk** ishin të pastra nga ana higjiëno-sanitare. Dyert e dhomave ishin të ndërtuara me profil alumini dhe sipërfaqe xhami.

Muret e brendshëm të dhomave të shoqërimit ishin me lagështirë dhe nuk ishin të mirëmbajtura. Gjithashtu, në dhomat e shoqërimit kishte mungesa të orendive të nevojshme si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, sikurse përcaktohet në pikën 4, Kreut VII të procedurave standarde “Rregullave teknike të shoqërimit në polici”.

Konkretisht, në dhomën e shoqërimit për personat e rritur ndodhej vetëm një stol, ndërsa në dhomën e shoqërimit për gra ndodhej vetëm një karrige, të cilat nuk përballonin qëndrimin ulur të të shoqëruarve, sipas kapacitetit fizik të dhomave apo në rastin e një fluksi të madh të të shoqëruarve në mjedisin e policisë.

Në ambientin e shoqërimit ndodheshin dy tualete, njëri prej tyre ndodhej brenda në dhomën e shoqërimit për të rriturit, ndërsa për të shoqëruarit gra tualeti ndodhej ambient më vete jashtë dhomës të shoqërimit. Këto ambiente nuk ishin të mirëmbajtura edhe pse ishin të pajisura me lavaman, çezma dhe kishin ujë pandërprerje.

Dhomat e shoqërimit nuk lidheshin me korridor të përbashkët dhe hyrje-daljet për në këto ambiente ishte direkte me pjesën e pasme të oborrit të institucionit. Këto ambiente nuk monitoroheshin me sistemin e kamerave. Ndërsa, ambienti jashtë dhomave të shoqërimit dhe territori i komisariatit monitorohej me sistemin e kamerave, të cilat ruheshin në serverin e sallës operative.

Në komisariatin e Policisë Elbasan gjatë periudhës 01.01.2022 deri më datë 15.06.2022 ishin shoqëruar gjithsej 159 persona sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 112 paragrafi 1 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” i ndryshuar. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në dhomat e shoqërimit nuk ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

Në ambientin dhe dhomat e shoqërimit, nuk u konstatuan sende dhe mjete të tilla që mund të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Thëksojmë se, dhomat e shoqërimit dhe zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109 paragrafi 5<sup>3</sup> dhe 122 paragrafi 5<sup>4</sup> e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4<sup>5</sup> të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Gjithashtu, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Elbasan, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

### **Ambientet e sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Në Komisaratin e Policisë Elbasan, ambienti i sigurisë nuk ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Kjo çështje është edhe më problematike përse në këto dhoma sigurie dërgohen edhe të ndaluarit/arrestuarit prej komisarateve të Librazhdit, Gramshit dhe Peqinit, në varësi të DVP Elbasan.<sup>6</sup>

Ambienti i sigurisë ndodhet në një godinë më vete brenda territorit të komisarimit. Godina e dhomave të sigurisë ishte një ndërtim i vjetër dhe i amortizuar gjendja e të cilit ishte përkeqësuar me kalimin e kohës. Në ambientin e brendshëm të saj ndodheshin 24 dhoma të cilat kanë qenë funksionale gjatë viteve të mëparshme, por aktualisht në përdorim ishin vetëm 8(tetë) dhoma sigurie të ndara më vete 6(gjashtë) dhoma për personat e ndaluar/arrestuar të rritur, 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur. Mekanizmi Kombëtar, nisur nga standardet që duhet të plotësojnë dhomat e sigurisë, evidenton se numri i dhomave dhe i shtretërve në këtë komisariat nuk janë të mjaftueshëm për të përballuar fluksin e personave të ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë të këtij komisarati dhe komisarateve në varësi të DVP Elbasan. Kapaciteti total i këtyre dhomave është 8 (tetë) persona.

---

<sup>3</sup> Neni 129 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar parashikon se: “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

<sup>4</sup> Neni 122 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar parashikon se: “Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.”

<sup>5</sup>Urdhri, nr. 938 datë 24.07.2019 “Procedura standarde e punës për: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.”

<sup>6</sup> Kreu VIII “Normat e parametrat e ndërtimit dhe të funksionimit të dhomave të sigurisë”, sipas Urdhrit nr. 925, datë 18.07. 2019 e procedurë standarde. Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”

Gjatë inspektimit na u bë me dije nga drejtuesit e institucionit se fondi për projektin për "*Rikonstruksionin/Ndërtimin e objekteve të Drejtorisë dhe Komisarariatit të Policisë Elbasan*" i cili përfshin rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e një objekti të ri për Drejtorinë, si dhe sistemimin e të gjithë territorit, është lëvruar. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me Autorizimin nr. 8346 datë 19.11.2021 ka autorizuar projektuesin për aplikim dhe ndjekjen të procedurave për sigurimin e lejes së ndërtimit.

Zbatimi i projektit parashikohet të fillojë menjëherë pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe lidhjes së kontratave dhe parashikohet të zgjasë 24 muaj. Procedura e prokurimit për shpalljen e operatorit ekonomik fitues ende nuk ka përfunduar, pasi nuk ka kaluar ende afati i ankimimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 162/2020, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*".<sup>7</sup>

Dhomat e tjera që ndodheshin në këtë ambient, për shkak se nuk plotësonin kushtet minimale për jetesë, ishin nxjerrë jashtë funksionit të përdorimit me procesverbal të rregullt, dyert e dhomave ishin të mbyllura me çelës dhe shulat e dyerve ishin të salduara.

Përmasat e dhomave të sigurisë ishin të vogla 3m x 2m dhe nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 m<sup>2</sup>, dhe nuk ishin të ndara në ambient qëndrimi në dhomë 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë 4m<sup>2</sup>, sikurse përcaktohet në kriteret e miratuara në procedurat standarde.<sup>8</sup>

Kjo problematikë është konstatuar edhe gjatë vizitës inspektuese në Komisarariatin e Policisë Elbasan të CPT (European Committee for the Prevention of Torture/Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës) në vitin 2018 dhe është evidentuar në raportin përfundimtar për Shqipërinë të botuar në muajin shtator 2019<sup>9</sup>. Pavarësisht këtij konstatimi dhe rekomandimit përkatës, situata në dhomat e sigurisë të këtij komisaritati vazhdon të jetë e njëjtë. *Avokati i Popullit me keqardhje vëren se niveli i zbatimit të këtij rekomandimi edhe pas 4 vitesh mbetet i ulët, kjo sipas gjetjeve tona kryesore mbi bazën e inspektimeve periodike.*<sup>10</sup>

Dritaret e dhomave të sigurisë ishin me përmasa të vogla, të cilat mundësonin futjen e ajrit, por jo të dritës natyrale, duke mos i plotësuar kriteret teknike për hapjen e tyre.

Kapaciteti sipas shtretërve të vendosur në çdo dhomë ishte për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) personave të ndaluar/arrestuar. Nga verifikimi, dhomat e sigurisë ishin të plotësuar me shtretër. Ndërsa në gjashtë

<sup>7</sup> Kjo ishte gjendja në momentin e inspektimit datë 15.06.2022, ndërsa aktualisht nga informacioni i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan na bëhet me dije se ka filluar investimi në dhomat e sigurisë, dhe personat e ndaluar/arrestuar janë transferuar në Bllokun e ri të sigurisë në Tiranë.

<sup>8</sup> Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde "*Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*".

<sup>9</sup> Raporti CPT për Shqipërinë botuar më 17 shtator 2019.

<sup>10</sup> Raporti i Avokatit të Popullit "*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe trajtimin çnjerëzor dhe degradues*", fq. 74. Korrik, 2022.

dhomat e tjera ndodheshin nga dy shtretër në secilën prej tyre. Dhomat e tjera ishin të pajisura me materialet e fjetjes si krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, por ato ishin mjaft të vjetruara dhe të dëmtuara. Ambienti në dhomat e sigurisë nuk ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare dhe kishte nevojë për lyerje e dezinfektim të vazhdueshëm.

Tualeti dhe ambienti i dusheve ndodheshin në korridorin e dhomave të sigurisë. Tualeti ishte i përbashkët dhe nuk ishte i ndarë më vete për meshkuj dhe gra. Muret e tualetit ishin të amortizuar, me lagështirë dhe kishte mungesa në detergjente dhe pajisje higjieno-sanitare. Furnizimi me ujë bëhej tre herë në ditë, me nga një orë ujë çka është tejet e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të ruajtjes së higjienës. Ambienti i dusheve ishte më vete, me dy poste për larjen e trupit në rast nevojë.

Ambienti i sigurisë të komisariatit nuk kishte sistem qendror ngrohjeje/ftohje me kaldajë, sikurse parashikohet në procedurat standarde, por në rastet kur temperaturat ishin të ftohta, ishin siguruar pajisje elektrike nga vetë institucioni, të cilat mbaheshin në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Nga inspektimi, u konstatua gjithashtu se në dhomat e sigurisë nuk kishte zile/buton të emergjencës, që të mundësonte komunikimin e personave të ndaluar/arrestuar me punonjës të shërbimit të policisë, në rast nevojë të ngutshme. Ndërsa në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte një aparat citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të komunikuar me sallën operative dhe kërkuar ndihmë në rast ndërhyrje. Ambienti dhe dhomat e sigurisë kishin burim rezervë energjie me vete me gjenerator.

Nuk kishte ambiente për të dalë në ajrim duke bërë që këto kushte nuk ofrojnë trajtim dnjitoz të personave që kalojnë midis 48 orë në 4-5 ditë në këto ambiente.

Dhoma për marrjen në pyetje nga prokurorët dhe për takime me avokatët të personave të ndaluar/arrestuar, ndodhej brenda ambientit të sigurisë. Ajo ishte e kompletuar me pajisje si tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave, por ato nuk ishin të fiksuara në dysheme, sikurse përcaktohen në kriteret e ndërtimit të dhomave të sigurisë në procedurat standarde<sup>11</sup>. Kjo dhomë gjithashtu, nuk kishte të instaluar sistemin e kamerave audio-vizive.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e dy kamerave përgjatë 24 orëve.

Nga intervista me personat që ndodheshin në ambientin e sigurisë dhe informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë, personat e ndaluar/arrestuar trajtoheshin me ushqim 3(tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr.189, datë 15.03.2017 “Për

---

<sup>11</sup> *Kreu VIII, pika 7 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*



*trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre*". Ushqimi shërbehej me katering dhe përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës të lidhur me të.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë dhe personat e arrestuar rezultoi se të ndaluarve/ arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente dhe letra higjienike.

Në ambientin e sigurisë kishte 4 (katër) persona të arrestuar gjatë kohës së inspektimit, të cilët u intervistuan nga grupi i inspektimit dhe në përfundim rezultoi se, ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së qëndrimit të tyre në ambientet e sigurisë dhe marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore.

Të intervistuarit patën pretendime në lidhje me kushtet e dhomës, duke qenë se nuk ishte në kushtet higjieno-sanitare të përshtatshme duke sjellë për pasojë një trajtim denigrues dhe jo human, ndërsa nuk u shfaqen nga ana tyre pretendime për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasojë emergjente të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Në komisaratin e Policisë Elbasan gjatë periudhës 01.01.2022 deri më 15.06.2022 ishin të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin përkatës gjithsej 290 persona sipas përcaktimeve të bëra në nenin 112 paragrafi 1 të ligjit nr. 108/2014 "*Për Policinë e Shtetit*" i ndryshuar.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 "*Për Policinë e Shtetit*", i ndryshuar dhe procedurës standarde "*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi e sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Nga inspektimi rezultoi se, regjistrat ishin të mbajtur në rregull, ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë, Elbasan, "*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*" ishte i tipit "*Model nr.1*" konform me procedurat standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>12</sup>.

Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë. Kjo situatë, u verifikua edhe për personat e ndaluar apo të arrestuar nga komisariatet e policisë të Librazhdit, Gramshit dhe Peqinit, të cilët në përfundim të procedurave ligjore të kryera nga specialistët e krimeve, dërgohen në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Elbasan.

Avokati i Popullit, ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e vendosjes në mbikqyrje policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Në lidhje me të arrestuarit e transferuar koha e qëndrimit në gjendje arresti nuk dokumentohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga këqyrja e regjistrave rezultoi se në vijim të rekomandimit tonë të fundit ishin marrë masa të menjëhershme për krijimin e një regjistri të veçantë për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjitha rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, megjithatë nuk ishte krijuar një regjistër i tillë për të miturit të arrestuar/ndaluar në konflikt me ligjin ku të evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të arrestuar/ndaluar në këto ambiente.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në Komisariatin e Policisë Elbasan, u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta me të drejtat e personave

---

<sup>12</sup> Kreu VII, procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe në 8 gjuhë të huaja, të cilat mbaheshin në dhomën e punës dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë Elbasan, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me të shoqëruarit në mjediset e policisë, në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës të ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar<sup>13</sup>.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Një problematikë e konstatuar nga grupi i inspektimi, kishte të bënte edhe me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të procesit së marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të policisë të shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018- të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë<sup>14</sup>. Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisarlatit. Sa më sipër është një praktikë që humbet qëllimin për të cilën ajo jepet.

---

<sup>13</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

<sup>14</sup> Komiteti European për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28<sup>14</sup>.

Grupi i inspektimit, evidentoi si një praktikë të mirë në Komisarariat e Policisë Elbasan, investimin e realizuar me fonde të Qeverisë Suedeze, krijimin e dy dhomave të përshtatura për intervistimin ashtu dhe për qëndrimin e të miturve të arrestuar/ndaluar apo të dënuar, të pajisura me orenditë e nevojshme dhe me kushte të përshtatshme bashkëkohore. Ato ishin të pajisura me të gjitha orenditë e nevojshme si tavolina, kolltuqe, bibliotekë për libra, postera informues, si dhe ishte e monitoruar me sistemin audio viziv. Intervistimet kryheshin në zbatim me ligjin nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, i mituri intervistohet nga psikologu, punonjësi social dhe i afërmi nëse i mituri dëshiron praninë e tij, dhe në çdo rast kur merret në pyetje nga oficeri i policisë, psikologu është gjithmonë i pranishëm. Intervistimet e të miturve në çdo rast kryheshin në këtë zyrë dhe zyra ishte funksionale.

Nga monitorimi që u bë zyrave të punonjësve të policisë në godinën e Komisarariatit të Policisë Elbasan, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 109 paragrafi 5 dhe 122 paragrafi 5 e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.P.P. parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit të personave të ndaluar/arrestuar nga grupi i inspektimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Gjithashtu nga intervista me personat që ndodheshin në ambientin e sigurisë, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në lidhje me trajtimin e personave në momentin që hyjnë në komisarariatet e policisë, sjellim në vëmendje nevojën e verifikimit të gjendjes fizike të personave, për të mënjanuar përgjegjësinë e autoriteteve të policisë, për çështjet e dhunës, sipas rekomandimit edhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin

ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), i cili në raportin për Shqipërinë të botuar në vitin 2019, midis të tjerave ka cituar se: *“Oficerët e policisë duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme”*<sup>15</sup>.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte i parashikuar në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan mirëpo rishtazi ishte larguar nga puna duke krijuar një problematikë në mbarëvajtjen e punës.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*<sup>16</sup>.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Mjeku në insitucion ishte i punësuar me kohë të pjeshme.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridoret e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, por ato duhen të vendosen edhe në vende ku mund të jenë të aksesueshme nga të ndaluarit dhe të shoqëruarit në mjediset e policisë.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

---

<sup>15</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-33>

<sup>16</sup> Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për mbylljen e dhomave ekzistuese të sigurisë dhe ndërtimin e ambienteve të reja të ndalim/arrestimit në Komisarlatin e Policisë Elbasan, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve të vjetruara të fjetjes me materiale të reja deri në rikonstruksionin e plotë të këtyre dhomave.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e një regjistri të veçantë për të miturit të arrestuar/ndaluar në konflikt me ligjin ku të evidentohen të gjitha rastet e të miturve të arrestuar/ndaluar në këto ambiente.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës me një mjek me kohë të plotë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës, lyerjen dhe dezinfektimin e dhomave të sigurisë.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare si dhe plotësimin e nevojave me detergjentë dhe furnizimin me ujë të pijshëm pa ndërprerje.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Elbasan, sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar dhoma shoqërimi të ndara më vete për personat meshkuj të rritur, femra dhe të mitur.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për lyerjen e dezinfektimin, si dhe kompletimin e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.
9. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave në Komisarlatin e Policisë Elbasan, ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.

10. Marrjen e masave për të vendosur posterat e rinj me të drejtat dhe kartën e të drejtave të personave që shoqërohen apo ndalohen në ambientet e komisariateve, në vende që të jenë të aksesueshëm nga këta persona.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.
12. Marrjen e masave për plotësimin e saktë të rregjistrit në lidhje me orën e shoqërimit.
13. Marrjen e masave për nisjen e procedurës disiplinore për punonjësit përgjegjës për mosplotësimin e përsëritur të rekomandimeve të Avokatit të Popullit pa implikime buxhetore.
14. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
15. Në projektimin dhe zbatimin e projektit të ri të mbahen në vëmendje të tëra parashikimet e rregullave teknike për ambientet e shoqërimit dhe sigurisë në Policinë e Shtetit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**

Punoi: G. Çarkaxhiu